



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 242, Datë 28.08.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“ALBPOWER” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 40, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2586/1 prot., datë 26.08.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPOWER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “ALBPOWER” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2586 prot., datë 21.08.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se ajo ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërma “a”, “b” si dhe pikën 2.5.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se, në vijim të procedurës, shoqëria duhet të plotësojë aplikimin me dokumentacionin dhe informacionin si më poshtë:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përqijthshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** dëshminë e penalitetit të përditësuar për shoqërinë.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “c”:** Sqarime dhe plotësime të planit të biznesit lidhur me sasinë e energjisë elektrike të parashikuara për t’u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve në vijim.

Dokumentacioni i depozituar vlerësohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës administrative,

Në vijim të procedurës, shoqëria “ALBPOWER” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe informacionin e sipërcituar, në përputhje me kërkesat e nenit 9 të Rregullores së Licencimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për licencimin e shoqërisë “ALBPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Shoqëria “ALBPOWER” sh.p.k. të depozitojë në ERE, në vijim të procedurës, dokumentacionin dhe informacionin plotësues si më poshtë: a) dëshminë e penalitetit të përditësuar për shoqërinë, në përputhje me nenin 9, pika 1.2, gërma “b”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

b) planin e biznesit të plotësuar, në të cilin të evidentohen, për secilin nga 5 (pesë) vitet e parashikuara të ushtrimit të veprimtarisë, sasinë e energjisë elektrike që shoqëria parashikon të tregtojë, të shprehura në MWh, në përputhje me nenin 9, pika 1.3, gërma “c”, të Rregullores së Licencimit.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “ALBPOWER” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI